



CIMC – 2007/04

RREGULLORE E DISTRIBUIMIT KABLLOR TË PROGRAMEVE RADIO TELEVIZIVE NË KOSOVË

Preambulë

Këshilli i Komisionit të Pavarur për Media (KKPM), duke vepruar në bazë të Nenit 2.5 dhe Nenit 11 të Ligjit për KPM-në, Nr. 02/L-15, dhe duke pasur parasysh:

1. Se sipas Ligjit për KPM-në, KKPM-ja është e udhëzuar të lëshojë licenca, përfshirë licencat për shërbime të shpërndarjes të programeve radio televizive përmes kablllove;
2. Se është e domosdoshme të vendoset një kornizë e organizuar rregulluese për shërbime të shpërndarjes të programeve radio televizive përmes kablllove në Kosovë;
3. Se korniza e përshkruar nën (2) më lart duhet të përfshijë dispozita për mbrojtjen e të miturve dhe konsumatorëve;
4. Se është e dëshirueshme të inkurajohet zhvillimi i një tregu të fuqishëm dhe konkurrence të shëndoshë në shërbimet televizive dhe shërbimet argëtuese, dhe se nga ajo konkurrencë do të përfitojnë konsumatorët e Kosovës;
5. Se investimi për shërbime të shpërndarjes të programeve radio televizive përmes kablllove do të mundësojë shërbime inovative dhe do të inkurajojë shtimin ekonomik në sektorin e Teknologjisë Informative dhe të Komunikimit (TIK), i cili është një nga sektorët ekonomik me rritjen më të shpejtë në Evropë;
6. Se duke promovuar zhvillimin e shërbimeve të shpërndarjes së programeve radio televizive përmes kablllove, është gjithashtu e dëshirueshme të inkurajohet edhe shërbimi i transmetimit tokësor i larmishëm dhe financiarisht i realizueshëm në Kosovë, (a) në bashkësitë lokale, dhe (b) në tërë Kosovën;

Për këtë arsye, miraton rregulloren vijuese në lidhje me licencat kablllore:

Neni 1

Përkufizimet

- 1.1. Transmetim kabllorë do të thotë shpërndarja e shërbimeve të programit kabllor nëpër sistemin kabllor të operatorit kabllor.
- 1.2. “Head-end kabllor (Cable head-end)” do të thotë mjeti kryesor për pranimin e sinjaleve për përpunim dhe shpërndarje nëpër sistemin kabllor.
- 1.3. Operator kabllor do të thotë operatori i sistemit kabllor i cili ofron shërbimet e programit kabllor përmes sistemit kabllor dhe i cili ka përgjegjësi për përmbajtjen e shërbimeve të programit kabllor.
- 1.4. Shërbimi i programit kabllor do të thotë radio dhe TV program për transmetim kabllor nëpër sistemin kabllor.
- 1.5. Parapagues kabllor do të thotë personi i cili pranon shërbimin e programit kabllor përmes sistemit kabllor, i cili ka kontratë me operatorin kabllor dhe që për shërbimet kabllore paguan një taksë.
- 1.6. Sistem kabllor do të thotë një sistem që përmban një paketë të transmetimit të mbyllur dhe gjenerim të shoqëruar të sinjalit, pajisje të kontrollit dhe shpërndarjes, i përcaktuar të ofrojë shërbim të programit kabllor për pranim nga parapaguesit kabllorë.
- 1.7. Televizion kabllor do të thotë operatori kabllor i cili prodhon programin e tij vetanak.
- 1.8. Ofruesi i shërbimeve të programeve përmes kabllor nënkupton biznesin që prodhon apo ofron në pako programe radio - televizive për transmetim kabllor.
- 1.9. Licenca për kabllorë do të thotë një autorizim, me të cilin definohen përgjegjësitë, e që është dhënë nga KPM-ja.
- 1.10. I licencuar për kabllor do të thotë subjekt fizik apo ligjor i regjistruar dhe i licencuar në pajtueshmëri me këtë rregullore.
- 1.11. Banor i Kosovës do të thotë personi i regjistruar në Regjistrin Civil Qendror si banor i përhershëm i Kosovës në pajtim me Rregulloren nr. 2000/13 të UNMIK-ut të datës 17 mars 2000, mbi Zyrën Qendrore të Regjistrimit Civil.
- 1.12. Operatorë aktivë kabllorë janë operatorë kabllorë të cilët u shërbejnë parapaguesve në Kosovë që nga data e tranzicionit.

Neni 2

Personat që kualifikohen për licencë

- 2.1. Personat fizik dhe personat juridik janë të kualifikuar të aplikojnë për licencë si operator kabllorë.
- 2.2. Personat fizik duhet të jenë banorë të Kosovës.
- 2.3. Personat juridik duhet të jenë të regjistruar në territorin e Kosovës në pajtim me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme në Kosovë.
- 2.4. KPM-ja do t'i lëshojë licencë cilitdo aplikues i cili kualifikohet për licencë duke dorëzuar aplikacionin për licencë i cili është i kompletuar dhe i vërtetë dhe i cili paguan taksën për licencë, *përveç nëse* licenca nuk do t'i lëshohet ose nuk do t'i vazhdohet:
 - 2.4.1 Partisë politike, një grupi ose organizate e cila është e menaxhuar nga një individ i cili mban pozitë të zgjedhur apo është anëtar i një bordi ekzekutiv i një partie politike;
 - 2.4.2 Individit ose entitetit që pjesërisht apo në tërësi është pronë ose menaxhohet nga një individ i cili ka qenë i dënuar me proces të rregullt, në pajtim me standardet ndërkombëtare, për krime të cilat përfshijnë dhunë ose mashtrim, për të cilat ai ose ajo nuk ka qenë i/e falur në mënyrë të ligjshme.

Neni 3

Kërkesat për licencë

- 3.1. Operatori kabllor duhet të ketë licencën për kabllor të lëshuar nga KPM-ja në mënyrë që të ndërtojë dhe operojë një sistem kabllorë në Kosovë.
- 3.2. Licenca për kabllorë është valide për një periudhë prej 10 (dhjetë) vite, me mundësi vazhdimi. I licencuari është i obliguar të parashtojë një kërkesë për vazhdim të licencës jo më vonë se gjashtë muaj para afatit të skadimit, por jo më herët se skadimi i periudhës nëntë vjeçare nga data e lëshimit të licencës.
- 3.3. Nuk do të kërkohet proces i parazgjedhjes për të marrë licencën për kabllorë. Posedimi i sistemit kabllorë nuk është as parakusht për të marrë atë licencë, e as që KPM-ja do të ketë ndonjë obligim ndaj operatorit kabllorë në lidhje me sigurimin e mjeteve të nevojshme ose burimeve.

Neni 4

Tranzicioni në licencim

- 4.1. Qëllimi i kësaj dispozite është të ofrohet mënyra që operatorët aktivë kabllorë të marrin licencat kabllore, përmes regjistrimit të menjëhershëm i cili do të përcillet me aplikacionin për licencë, siç përshkruhet në Nenet 5 dhe 6.
 - 4.1.1 Operatorë aktivë kabllorë janë operatorë kabllorë të cilët shërbejnë parapaguesit në Kosovë deri në datën e tranzicionit.
 - 4.1.2 Data e tranzicionit është data e miratimit të kësaj rregulloreje në formën e saj përfundimtare.
- 4.2. Operatorët aktivë kabllorë duhet të regjistrohen në KPM në pajtim me Nenin 5, brenda një muaji pas datës së tranzicionit.
- 4.3. Pas regjistrimit, operatorët aktivë kabllorë duhet të aplikojnë për licencë për kabllorë, duke përmbushur të gjitha kërkesat e Nenit 6, deri në afatin e dhënë për licencim. Data e mbarimit të afatit të dhënjës së licencës është tre muaj pas datës së tranzicionit.
- 4.4. Operatori aktiv kabllor cili dështon për të dorëzuar një aplikacion brenda afatit të përcaktuar për licencë nuk mund të operojë një sistem kabllor dhe i nënshtrohet sanksioneve sipas ligjit mbi KPM-në.
- 4.5. Çdo operator kabllor i cili nuk është operator aktiv kabllor deri në kohën e tranzicionit duhet të aplikojë për licencë sipas Nenit 8 dhe mund të aplikojë në çdo kohë.

Neni 5

Regjistrimi i operatorëve aktivë kabllorë

- 5.1. Operatorët aktivë kabllorë të cilët aplikojnë për regjistrim duhet të regjistrohen jo më vonë se një muaj pasi që kjo rregullore të jetë miratuar në formën e saj përfundimtare nga ana e Këshillit të KPM-së.
- 5.2. Aplikuesi duhet të ofrojë informatat e mëposhtme për regjistrim:
 - 5.2.1. Emri i aplikuesit me adresë, telefon, faks, dhe adresë të postës elektronike (email) të zyrës kryesore të biznesit.
 - 5.2.2. Nëse aplikuesi është person juridik, forma e pronësisë (partneritet, shoqëri komerciale, kompani me përgjegjësi të kufizuar, etj.) dhe certifikatën e regjistrimit të biznesit.
 - 5.2.3. Emri i individit (personit fizik) përgjegjës për dorëzimin e informatave për regjistrim, përfshirë numrin personal, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike.
 - 5.2.4. Hartën që tregon sistemin aktual kabllor (head-endi kryesor,

head-endet tjera dhe shtrirjen e kabllorës) (hartat duhet të jenë në shkallë të mjaftueshme për të treguar rrugët dhe mënyrat se ku ndodhet shtrirja e kabllorës).

- 5.2.5 Adresa e head-endit apo e head-endave.
- 5.2.6 Numrin e parapaguesve.
- 5.2.7 Shërbimet e ofruara dhe tarifat me të cilat ngarkohen parapaguesit për secilin shërbim broadband ose kombinim të shërbimeve.
- 5.2.8 Lista e programeve (lista e të gjitha shërbimeve programore të ofruara me sistemin kabllorë, me numër të kanalit), përfshirë edhe stacionet televizive transmetuese tokësore.
- 5.2.9 Ofruesi i shërbimeve kabllorë ka obligim të blejë të gjitha të drejtat e autorit, dhe të ngjashme, prej pronarit të shpërndarjes së programit para se programi të shpërndahet. Këtu përfshihen e drejta e autorit dhe e drejta e interpretuesit, për të gjitha përmbajtjet e programeve të shpërndara, dhe në pajtueshmëri me gjithë legjislacionin relevant dhe dispozitat në këtë fushë.
- 5.2.10 Operatorët aktiv kabllorë duhet që në ditën e aplikimit për licencë të sigurojnë kopjet e marrëveshjeve për çdo shërbim të programit që është transmetim kabllor në sistemin kabllor.

5.3. Për operatorët aktivë kabllorë, periudha e negocimit për transmetimin e domosdoshëm tokësor, e përshkruar në Nenin 12, fillon nga data e regjistrimit.

Neni 6

Licencimi i operatorëve aktivë kabllorë

- 6.1. Operatorët aktivë kabllorë duhet të aplikojnë për licencë jo më vonë se tre muaj pasi që kjo rregullore të jetë miratuar në formën e saj përfundimtare nga ana e Këshillit të KPM-së.
- 6.2. Në mënyrë që të pajisen me licencë, operatorët aktivë kabllorë duhet të:
 - 6.2.1 Plotësojnë aplikacionin për licencë për secilin sistem kabllor të drejtuar nga aplikuesi.
 - 6.2.2 Paguajnë taksën vjetore për licencë sikurse është përcaktuar në Nenin 10.
- 6.3. Aplikacioni për licencë duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:
 - 6.3.1. Informatat rreth aplikuesit:
 - a) Emri i aplikuesit me adresë, telefon, faks, dhe adresë të postës elektronike të zyrës kryesore të tyre.
 - b) Nëse aplikuesi është person juridik, forma e pronësisë (partneritet, shoqëri komerciale, kompani me përgjegjësi të kufizuar, etj.), dëshmi mbi regjistrimin e biznesit në Kosovë.

- c) Emri i individit (personit fizik) përgjegjës për dorëzimin e informatave për regjistrim, përfshirë numrin personal, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike.

6.3.2. Informata rreth sistemit kabllor – lokacioni

- a) Hartën që tregon lokacionin e sistemit kabllor në të cilën operon aplikuesi (head-endin kryesore, head-endet tjera dhe shtrirjen e kabllor) (hartat duhet të jenë në përpjestim të zmadhuar për të treguar rrugët dhe mënyrën se ku ndodhet shtrirja e kabllor).
- b) Adresa e head-endit ose head-endeve të tjerë.
- c) Data kur aplikuesi për herë të parë i ka ofruar shërbime parapaguesve.
- d) Përshkrim i shkurtër i teknologjisë së përdorur në sistemin kabllorë.

6.3.3. Informata rreth sistemit kabllor – parapaguesit

- a) Lista e shërbimeve të ofruara dhe tarifat me të cilat ngarkohen parapaguesit për secilin shërbim të brezit të gjerë (broadband) ose kombinim të shërbimeve.
- b) Numri i parapaguesve
- c) Një mostër të kontratës me parapaguesit

6.3.4. Informata rreth shërbimeve të programeve kabllore

- a) Lista e programeve (lista e të gjitha shërbimeve kabllore të ofruara përmes sistemit kabllor me numër të kanalit, përfshirë stacionet televizive transmetuese tokësore).

- 6.2.5. Si pjesë e aplikacionit, aplikuesi duhet që që në ditën e aplikimit për licencë t'i sigurojë kopjet e marrëveshjeve për çdo shërbim të programit që është transmetim kabllor në sistemin kabllor.

Neni 7

Aplikacioni për licencë

7.1. Qëllim i këtij neni është për të caktuar procedurën në mënyrë që aplikuesi të aplikojë për licencë për ta ndërtuar dhe për ta vënë në funksion sistemin kabllor.

7.2. Në mënyrë që të pajiset me licencë, aplikuesi duhet:

- 7.2.1 Të plotësojë aplikacionin për licencë;
- 7.2.2 Të paguajë taksën për licencë për vitin e parë sikurse është përcaktuar në Nenin 10;
- 7.2.3 Pajtohet të fillojë t'u ofrojë shërbime parapaguesve brenda 12 muajve pas lëshimit të licencës.

- 7.3. Aplikacioni për licencë duhet të përmbajë informatat e mëposhtme:
- 7.3.1. Informata lidhur me aplikuesin:
- a) Emri i aplikuesit me adresë, telefon, faks, dhe adresa e postës elektronike të selisë qendrore të biznesit të tyre.
 - b) Nëse aplikuesi është person juridik, forma e pronësisë (partneritet, shoqëri komerciale, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, etj.), dëshmi mbi regjistrimin e biznesit në Kosovë.
 - c) Emri i individit (personit fizik) përgjegjës për dorëzimin e aplikacionit për licencë, përfshirë numrin personal, numrin e telefonit dhe adresën e postës elektronike.
- 7.3.2. Informata rreth sistemit kabllor – lokacioni dhe numri i parapaguesve.
- a) Hartën që tregon lokacionin e planifikuar të sistemit kabllor. Hartat duhet të jenë në përpjestim të zmadhuar për të treguar rrugët dhe mënyrën se ku ndodhet shtrirja e kabllor dhe lokacioni i head-endit.
 - b) Adresa e head-endit.
 - c) Numri i parapaguesve.
- 7.3.3. Informata rreth sistemit kabllor – informata teknike.
- a) Një përshkrim të shkurtër të teknologjisë që do të përdoret nga sistemi kabllor, përfshirë këtu edhe se sa kanale aplikuesi ka për qëllim të ofrojë.

Neni 8

Ndërrimi i pronësisë

- 8.1. Ndryshimet në pronësinë e sistemit kabllor duhet të kenë miratimin paraprak me shkrim nga KPM-ja.
- 8.2. Nëse në kohën e transferimit, sistemi kabllor nuk është në përputhje me Ligjin për KPM-në, pronari i ri së bashku me kërkesën për planin e transferimit duhet të dorëzojë edhe orarin sipas të cilit ai do ta sjell sistemin në pajtueshmëri me ligjin.

Neni 9

Përtëritja e licencës

- 9.1. Operatori kabllor ka të drejtë të kërkojë përtëritjen e licencës së tij për kabllor. Operatori kabllor është i obliguar të parashtojë një kërkesë për përtëritje të licencës jo më vonë se gjashtë muaj para datës së skadimit të licencës, por jo para skadimit të periudhës nëntë vjeçare nga data e lëshimit të licencës.
- 9.2. Në vendimin për përtëritje të licencës KPM-ja do të merr parasysh respektimin apo mosrespektimin e ligjeve dhe rregulloreve të KPM-së nga ana e operatorit kabllor.

9.3. Kërkesa për përtëritje e operatorëve kabllorë duhet të përmbajë informatat e kërkuara në nenin 6.3.

Neni 10 Taksat për licencë

10.1. Çdo operator kabllor duhet të paguajë taksën vjetore. Niveli i taksës vjetore është i përcaktuar me një vendim të posaçëm.

Neni 11 Përmbajtja e shërbimit kabllor: Të drejtat dhe përgjegjësitë e operatorëve kabllorë

11.1. Çdo operator kabllor ka të drejtë të përcaktojë se çfarë shërbimesh të programeve do të shpërndahen përmes sistemit të tij të licencuar kabllor, përveç nëse ajo e drejtë kufizohet nga kjo rregullore.

11.2. Çdo operator kabllor ka përgjegjësi për të garantuar se përmbajtja e të gjitha shërbimeve të programit të shpërndara përmes sistemit kabllor është në përputhje me Ligjin për KPM-në dhe rregulloret, si dhe me kërkesa tjera ligjore.

11.3. Nëse një operator kabllor gjen se një shërbim i programit ka përmbajtje ilegale, edhe pse ai ka ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme të kujdesit, operatori kabllor duhet ta ndërpresë menjëherë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e këtillë nuk do të përsëritet.

11.4. Operatori kabllor do të ofrojë shërbime për gjithë parapaguesit në baza jo-diskriminuese. Operatori kabllorë nuk do të bëjë përzgjedhje të parapaguesve në baza etnike, fetare, gjinie, pasurie apo ndonjë baze tjetër. Shërbimi kabllorë duhet t'u ofrohet të gjithë qytetarëve në zonën e mbulimit që teknikisht janë të lidhur me atë shërbim, dhe do të konsiderohet se çdo person që pranon kushte të veçanta dhe jo-diskriminuese të ofertës ka të drejtë të arrij kontratë parapagimi.

11.5. Operatori kabllor nuk është i autorizuar të shpërndaj programe të koduara satelitore apo tokësore. Shpërndarja e programeve të koduara satelitore është i autorizuar vetëm nëse operatori kabllorë ka arritur një kontratë ekskluzive me pronarin e programit të tillë në të cilën dekodimi është i autorizuar për shpërndarje të mëtejshme. Do të konsiderohet se operatori kabllorë nuk ka blerë të drejtën e shpërndarjes së programeve të tilla nëse operatori kabllorë ka blerë një kartelë dekodimi të përcaktuar për parapagues individual.

Neni 12

Kërkesat për transmetim të obligueshëm

- 12.1. Në mënyrë që të promovohet diversitetet dhe shërbim financiarisht i realizueshëm i transmetimit tokësor në Kosovë; (a) në bashkësitë lokale, dhe (b) në tërë Kosovën, të licencuarit për shërbimet kabllore në Kosovë i nënshtrohen kërkesave të mëposhtme të cilat janë të obligueshme, me përjashtim të radio stacioneve.
- 12.2. Të gjitha sistemet kabllore janë të obliguara të transmetojnë transmetuesin publik, RTK. RTK-ja duhet të bartet pa pagesë. RTK-ja duhet të ofrojë programin e njëjtë për transmetim përmes kabllorit si atë që ofron edhe për transmetimin tokësor.
- 12.3. Stacionet tjera transmetuese tokësore në Kosovë kanë mundësitë vijuese:
- 12.3.1 Periudha e negociimit prej tre muajve fillon kur sistemi kabllor fillon të shërbejë parapaguesit në zonën e licencuar të transmetuesit tokësor.
 - 12.3.2 Gjatë periudhës së negociimit, operatori kabllor dhe transmetuesi tokësor mund të negociojnë sa i përket kushteve ekonomike mbi të cilat programi i transmetuesit tokësor mund të transmetohet përmes kabllorit.
 - 12.3.3 Nëse operatori kabllor dhe subjekti transmetues tokësor nuk mund të arrijnë marrëveshje para përfundimit të periudhës për negociim:
 - a) Subjekti transmetues tokësor mund të vendos ose të ketë statusin “e obligueshëm ” ose të refuzojë bartjen.
 - b) Nëse transmetuesi tokësor zgjedh statusin “e obligueshëm” operatori kabllor duhet të bart programin e transmetuesit tokësor pa asnjë ndryshim ose modifikim dhe pa kompensim.
 - c) Nëse transmetuesi tokësor zgjedh të refuzojë bartjen, operatori kabllor nuk ka të drejtë të bart programin e transmetuesit tokësor.

Neni 13

Kërkesat Operacionale për të Licencuarit e shërbimeve Kabllore

- 13.1. Operatori kabllor është i obliguar të mirëmbajë veprimtarinë e tij në atë mënyrë që të mos i shkaktojë pengesa teknike dhe të dëmshme parapaguesve ose të pengojë parapaguesit nga përdorimi i shërbimeve nga operatori tjetër kabllor i licencuar.
- 13.2. Operatori kabllor është i obliguar të publikojë një ofertë të përhershme

për shpërndarjen e programeve për një grup subjektsh transmetuese të licencuara në Kosovë zona e mbulimit të cilave është brenda zonës së sistemit për pranimin e sinjalit të radios dhe televizionit përmes të cilit është duke u bërë shpërndarja Cilido transmetues tokësor i licencuar, i cili pranon ofertën për shpërndarjen e programit të tij, sa i përket shpërndarjes në raport me të gjitha stacionet tjera në të njëjtin grup, ka të drejtë të trajtohet sipas kushteve të njëjta.

- 13.3. Në rast se operatori kabllor ndërron shpërndarjen e radio ose TV programeve, operatori kabllor është i obliguar të publikojë listën e çmimeve të shpërndarjes e cila duhet të përfshijë elementet e përcaktimit të çmimit në mënyrë që i njëjti të llogaritet në mënyrë të qartë, ndërsa e drejta për një shpërndarje të tillë mund të merret nga cilido transmetues. Operatori kabllor do të mbajë librat e kontabilitetit për shërbimet e caktuara sipas kësaj licence ndaras nga shërbimet tjera që ai ofron.
- 13.4. Operatorët kabllorë të cilët kanë licencë, dhe përmes saj ata në sistem transmetojnë edhe programet e tyre, do të jenë të obliguar të aplikojnë parimet e njëjta të përcaktimit dhe ngarkesës së çmimeve, si dhe të njëjtat kushte biznese për subjektet e tjera në sistem që merren me shërbimin e shpërndarjes së radio dhe TV programeve, në të njëjtën mënyrë sikurse aplikohet në biznesin e tyre, të rritur për një fitim të arsyeshëm.

Neni 14

Këshilli Programor i Operatorëve Kabllorë

- 14.1. Operatori kabllor ka Këshill të Programit i cili në pajtim me këtë rregullore dhe me aftësitë teknike të operatorit kabllorë vendos se cilat radio ose TV programe do të ofrohen në sistemin e operuar nga operatori kabllor. Vendimi i Këshillit duhet të bazohet në Nenin 12 dhe 12 a të kësaj rregulloreje. Mandati dhe përbërja e këshillit dhe përgjegjësitë tjera të Këshillit do të përcaktohen në një dokument të brendshëm të miratuar nga operatori kabllor.
- 14.2. Dokumentin e brendshëm nga paragrafi 1 dhe aktin e emërimit të anëtarëve të Këshillit të Programit, përfshirë të gjitha ndryshimet në këtë dokument, operatori kabllor ia dërgon KPM-së 15 ditë nga dita e prezantimit të tyre.

Neni 15

Kërkesat teknike (shfrytëzimi i spektrit dhe përhapja e valëve)

- 15.1. Transmetimi dhe ritransmetimi i programeve radio televizive nga operatorët kabllorë duhet të bëhet vetëm në brezin frekuencor të paraparë për këto shërbime, respektivisht brezat S të përcaktuara nga Komiteti Ndërkombëtar Konsultativ i Radiove (KNKR).
- 15.2. Operatori kabllor duhet të ndërtojë dhe mirëmbajë sistemin kabllor sipas standardeve të mira teknike. Operatori kabllor është përgjegjës për çfarëdo

ndërhyrje në frekuencat transmetuese të shkaktuara nga përhapja e valëve përmes sistemit televiziv kabllor. Nëse KPM-ja informohet se një përhapje e tillë e valëve është duke ndodhur, KPM-ja do të njoftojë operatorin kabllorë dhe do ti jap më së shumti 30 ditë për përmirësim. Nëse përhapja vazhdon KPM-ja do të vendos sanksione në pajtim me Ligjin dhe Rregulloret e saja.

Neni 16

Kërkesat për Ofruesit e Shërbimeve Kabllore dhe Ofruesit e shërbimit të programeve kabllore si prodhues

- 16.1. Operatori kabllor i cili prodhon dhe ofron program të vetin duhet të jetë i regjistruar për shërbime të transmetimit.
- 16.2. Ofruesi i shërbimeve kabllore i cili prodhon programin e tij të radios ose televizionit do të ketë statusin e Stacionit Televiziv Kabllor kur shpërndan programin e vet nëpërmes sistemit kabllor.
- 16.3. Ofruesi i shërbimeve kabllore i cili është edhe transmetues duhet që brenda 12 muajve të vendos struktura të ndara të kontabilitetit dhe menaxhimit për shpërndarje përmes kabllorit si dhe për ato të veprimtarisë transmetuese. Operatori kabllor i tillë është i obliguar të aplikojë sipas kushteve të njëjta me transmetuesit tjerë të shpërndarë si pjesë e shërbimeve të tij meqë vlen për programin(et) vetanak.
- 16.4. Ofruesi i shërbimeve programore përmes kabllorit do të rregullohet si subjekt transmetues në pajtim me Ligjin e KPM-së.

Neni 17

Mbrojtja e parapaguesve

- 17.1. Operatori kabllor duhet të lidhë kontratë me parapaguesit. Kontrata duhet të theksojë qartë:
 - 17.1.1 Çmimin e lidhjes fillestare në sistemin kabllor,
 - 17.1.2 Pagesën mujore që duhet bërë për shërbimin kabllor;
 - 17.1.3 Një përshkrim të shkurtër për shërbimin e ofruar kabllor, dhe
 - 17.1.4 Një numër telefoni ku parapaguesi mund të telefonojë për të informuar operatorin kabllor për problemet në shërbimin kabllor.
- 17.2. Operatori kabllor duhet po ashtu t'i sigurojë çdo parapaguesi të ri listën a kanaleve, e kjo nënkupton një listë për çdo shërbim të programit në dispozicion në sistemin kabllor, duke përfshirë këtu edhe kanalet e transmetuesve televiziv. Lista duhet të tregojë kanalin kabllor për secilin program të bartur.
- 17.3. Operatorët kabllorë duhet që së paku 30 ditë më parë të njoftojnë parapaguesit për çfarëdo ndryshimi në çmimoren mujore të shërbimit kabllorë dhe në të njëjtën kohë të njoftojnë edhe KPM-në.

- 17.4. Kurdo që të jetë e mundur operatorët kabllorë duhet të njoftojnë parapaguesit 30 ditë më parë mbi qëllimin për të ndryshuar programet televizive të ofruara me këtë sistem, që është qëllimi për të larguar disa programe nga sistemi kabllor ose për të shtuar shërbime të programeve të reja. Operatori kabllor mund të njoftojë parapaguesit përmes mjeteve elektronike.
- 15.5. Operatori kabllor do të sigurojë shërbim kabllor për të gjithë parapaguesit në baza jo diskriminuese.

Neni 18

E drejta e KPM-së për raporte dhe inspektime

- 18.1. Me qëllim të (a) monitorimit të përmbushjes së termeve dhe kushteve të licencave kabllore, dhe (b) kryerjes së obligimeve të KPM-së sipas nenit 3.3 të Ligjit mbi KPM-në, KPM-ja mund të kërkojë që të licencuarit të dorëzojnë raport vjetor dhe raporte të rastit mbi aspekte të posaçme të punës së tyre.
- 18.2. KPM-ja ka të drejtë të inspektojë çfarëdo pjesë të sistemit kabllor në çdo kohë, të inspektojë dokumentet dhe shënimet me paralajmërim paraprak të arsyeshëm dhe të monitorojë numrin, kualitetin dhe përmbajtjen e të gjitha shërbimeve programore të ofruara nga të licencuarit.
- 18.3. KPM-ja mundet që në çdo kohë të kërkojë nga të licencuarit që të ofrojnë të gjitha kontratat për të drejtat e autorit.
- 18.4. Çdo i licencuar duhet t'i paraqesë KPM-së një herë në vit listën e programeve për secilin nga sistemet e tij të licencuara të kabllorit.

Neni 19

Sanksionet

- 19.1. Operatorët kabllorë do t'i nënshtrohen sanksioneve siç janë të përcaktuara për subjektet transmetuese në Nenin 20 dhe Nenin 21 të Ligjit mbi KPM-në.
- 19.1.1 KPM-ja, për shkak të shkeljes së kushteve dhe termeve të licencës së tanishme mund të nisë procedurën për revokim të licencës në pajtueshmëri me Ligjin.
- 19.1.2 Nëse operatori kabllor bart një ofrues të shërbimeve të programit kabllor pa të drejtën e autorit, KPM mund të iniciojë procedurë ligjore kundër të licencuarit kabllor në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së.
- 19.1.3 Në rast të tërheqjes ose suspendimit të licencës, i licencuari nuk ka të drejtë të kompensohet për taksat tashmë të paguara.
- 19.1.4 Procedura për lëshimin e vendimit mbi tërheqjen e licencës, me të

drejtat e të licencuarit të përcaktuara në paragrafin 1, do të inicohet në rastet e poshtëshënuara:

- a) Nëse i licencuari nuk fillon me ofrimin e shërbimeve brenda gjashtë muajve prej datës së lëshimit të licencës ose brenda periudhës së zgjatur të afatit të lartpërmendur, në rast se kjo periudhë paraprakisht është aprovuar me shkrim nga KPM-ja.
- b) Nëse i licencuari nuk vepron në pajtueshmëri me vendimin e lëshuar nga KPM-ja ose nuk rregullon gabimet përkatëse brenda periudhës prej 15 ditësh nga data e lëshimit të vërejtjes ose gjatë ndonjë kufizimi tjetër të vendosur nga KPM-ja në formë të shkruar.
- c) Në rast se i licencuari konstatohet se ka falimentuar, licenca nuk do të jetë e vlefshme në ditën e ndërprerjes së ekzistimit të licencuarit ose në ditën e skadimit të periudhës së fundit për të cilën janë paguar taksat.


Neni 20 Informimi

20.1. KPM-ja është e zotuar për transparencë në procesin e zbatimit dhe licencimit.

20.2. Nëse operatori kabllor i dorëzon informata të besueshme KPM-së, KPM-ja do t'i mbajë ato informata në besim përveç nëse me ligj kërkohet ndryshe.

Neni 21 Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.


Isuf Berisha
Kryetar i Këshillit të KPM-së



06.07.07

Datë